

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **OPERATORIN EKONOMIK “2T”**
Rruga. “Asim Vokshi” ndertesa 14, hyrja 4, Ap.5, Tiranë

Procedura e prokurimit: Punë/ **Procedure e Hapur**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-81320-07-30-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Stabilizim i rrëshqitjes në aksin Tunel – Elbasan, km17.36 ÷ 17.46 segmenti 3, aksi Tiranë – Elbasan (dalje Tuneli i Krrabës km.15.2–Elbasan km.27”, me fondin limit 373.979.239,10 lekë pa TVSH. Numri i referencës së procedurës REF-81320-07-30-2018, Afati i zbatimit te kontrates 4 muaj.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve 06.08.2018] [Nr.31]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “2T” K01731001M

Vlera 371 178 286.04 *treqind e shtatedhjete e nje milion e njeqind e shtatedhjete e tete mije e dyqind e tetedhjete e gjashte presje zero kater*) Lekë pa përfshirë vleren e tvsh-së.

2. Lala & Shans Invest,& Bila & Jody Kompany J76418903B/ J61924002T
/K32618815N /J94824803M

Vlera 341 220 063 *(treqind e dyzete e nje milion e dyqind e njezete mije e gjashtedhjete e tre)* Lekë pa përfshirë vleren e tvsh-së.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.Bashkimi i Operatoreve ekonomik Lala shpk & Shanci Invest shpk & Biba X shpk & Jody Company shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Nuk ka permbushur ne perputhje me dokumentet e tenderit piken 2.3.3. Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Operatori ekonomik Shanci Invest shpk, pjese e ketij bashkimi ne 39% te punimeve ku sipas zerave te punimeve ka marre perisper te kryej punime ne struktura dhe pilota, nuk disponon kategorite e meposhtme te licences, te kerkuar ne dokumentet e tenderit:

- NS – 20/B Shpime Gjeologo – inxhinierike, puse e shpime per uje

Operatori ekonomik **Biba X shpk**, pjese e ketij bashkimi ne 25 % te punimeve nuk disponon kategorite e meposhtme te licences, te kerkuar ne dokumentet e tenderit:

- NP – 5/C Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- NP - 9/C Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
- NP – 12/D Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS – 9/D Punime strukturore speciale
- NS - 18/ B Punime topogjeodezike
- NS – 20/B Shpime Gjeologo – inxhinierike, puse e shpime per uje

Operatori ekonomik **Jody Company shpk**, pjese e ketij bashkimi ne 16 % te punimeve ku sipas zerave te punimeve ka marre persiper te kryej kryesisht shtresat asfaltike, nuk disponon kategorite e meposhtme te licences, te kerkuar ne dokumentet e tenderit:

- NP – 1/D Punime germimi ne toke.
- NP – 4/F Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- NP – 5/C Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- NP - 9/C Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
- NP – 12/D Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS – 9/D Punime strukturore speciale
- NS -18/ B Punime topogjeodezike
- NS – 20/B Shpime Gjeologo – inxhinierike, puse e shpime per uje

Kjo, ne kundershtrim me VKM-ne, nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74, pika 3, ku thuhet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, **financiare, profesionale dhe ato teknike** duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me **përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje**”.

Ne licencen profesionale te Operatori ekonomik **Biba X shpk**, pjese e ketij bashkimi ne 25% te punimeve, me Nr. NZ.4319/5, date 15.04.2013, rezulton qe, per drejtuesit teknike te saj z. Jakup Vogli dhe z. Elidjon Kaso, nuk jane derdhur sigurimet shoqerore e shendetesore, kjo ne kundershtrim me “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, pika 2, te DST-se, ku percaktohet se subjekti duhet te kete paguar te gjitha detyrimet e sigurimeve shoqerore.

Po keshtu kjo bie ne kundershtrim edhe me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtime, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 9/c ku percaktohet se *Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë. Dhe ne vijim Kreu VII ku percaktohet se Shoqërise qe kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore, komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.*

Ne licencen profesionale te Operatori ekonomik **Shanci Invest shpk**, pjese e ketij bashkimi ne 39% te punimeve, me Nr. NZ.1495/18, date 21.02.2017, rezulton qe, per drejtuesin teknike te saj z.

Kajtaj Rataj, nuk jane derdhur sigurimet shoqerore e shendetesore, kjo ne kundërshtim me “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit”, pika 2, te DST-se, ku percaktohet se subjekti duhet te kete paguar te gjitha detyrimet e sigurimeve shoqerore.

Po keshtu kjo bie ne kundërshtim edhe me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 9/c ku percaktohet se *Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë. Dhe ne vijim Kreu VII ku percaktohet se Shoqërise qe kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore, komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.*

Bashkimi i operatoreve ekonomik nuk ka permbushur piken 2.3.1, te kerkesave per kualifikim, pasi nuk rezulton të ketë realizuar: *a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerë jo më të vogël se 50% të vleres se kontrates qe prokurohet, që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit, ose b) punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% të vleres se kontrates qe prokurohet.* Objektet e paraqitur nuk rezultojne te jene kontrata te ngjashme ne fushen e ndertimit te rrugeve apo mirembjaten e skarpateve etj, por jane punime kryesisht ne energji dhe ne kanalizime. Operatori ekonomik Shanci Invest shpk, pjese e ketij bashkimi ne 39% te punimeve nuk permbush kriterin per pune te ngjashme ne perputhje me VKM-ne, nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74, pika 3, ku thuhet: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

Bashkimi i operatoreve ekonomik nuk ka permbushur piken 2.3.12, dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per kapacitetet: *makineri per shpime ne lartesi deri ne 30 m, në pronësi ose me qira, copë 1; makineri per sprucim shotcrete deri ne 30m, në pronësi ose me qira, copë 1; makineri per injektim ne lartesi, në pronësi ose me qira, copë 1; sonda shpimi per anker, në pronësi ose me qira, copë 4; pompe per hidrombjellje, ne pronesi ose me qera, cope 3; Cekic vibrues (fuqi vibrimi min.115kw, forca terheqese min.150 kN,forca shtytese min 600 kN, ne pronesi ose me qera, cope 1, ne kundërshtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.*

Ne vërtetimin e paraqitur që konfirmon shlyerjen e pagesave te energjise elektrike, rezulton qe **Operatori ekonomik Jody Company shpk**, pjese e ketij bashkimi ne kundërshtim me piken 1/dh te kriterëve te veçanta per kualifikim nuk ka shlyer detyrimet të maturuara të energjisë elektrike te muajit korrik 2018. (Mbi detyrimet e maturuara sipas Vendimit te ERE-s, Nr.109, date 21.10.2011, “Per miratimin e kontratës se furnizimit me energji elektrike te klientëve jofamiljare, neni 9/1, Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se **ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**”)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “2T” me adrese **Rruga. “Asim Vokshi” ndertesa 14, hyrja 4, Ap.5, Tiranë** . se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 371 178 286.04 (*treqind e shtatedhete e nje milion e njeqind e shtatedhete e tete mije e dyqind e tetedhete e gjashte presje zero kater*) lekë pa tvsh/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Autoritetit Rrugor Shqiptar/ Sektori i Prokurimeve] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera perkatese e shprehur ne fjalr dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.09.2018

Ankesa: Nuk ka

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____